

VENDIM
Nr.47, datë 29.8.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Halil Kopani,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

Me sekretare arbenka Lalica, më datat 7.11.1996 dhe 25.8.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.4/3 Akti që i përket:

KËRKUES: PETRIT SELACI, i përfaqësuar nga Av.Vasil Dode.

O B J E K T I:

Shpalljen antikushtetues të vendimit nr.20, datë 21.6.1995 të gjykatës ushtarake të rrethit Durrës dhe vendimit nr.261, datë 13.11.1995 të kolegjit penal të Gjykatës së Kasacionit Tiranë, në bazë të nenit 24 pika 9 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE E SHQIPËRIË, pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuari Petrit Selaci në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shpalljen antikushtetues të vendimit të gjykatës ushtarake të rrethit Durrës dhe të vendimit të kolegjit penal të Gjykatës së Kasacionit, ka parashtruar këto shkaqe:

- Çështja penale është gjykuar në shkallë të parë me trup gjykues të përbërë prej një gjyqtari dhe dy ndihmësgjyqtarëve, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.7921, datë 19.04.1995 "Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale", të cilat urdhërojnë që krimet të gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë;

- Gjykata nuk ka verifikuar nëse dy ndihmësgjyqtarët që kanë marrë pjesë në trupin gjykues, janë miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë;

- Nga Gjykata e Kasacionit është shqyrtuar çështja pa u njoftuar i gjykuari Petrit Selaci, duke iu mohuar kështu e drejta e ankimit;

- Hetimi gjyqësor në gjykatën ushtarake të rrethit, është zhvilluar në mënyrë të parregullt, dhe të njëanshme, duke u mbështetur në prova e fakte të siguruara në kundërshtim me normat procedurale, nën presion e dhunë, nga persona të paautorizuar;

- Të gjitha këto shkelje çënojnë procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat e tjera të parashikuara nga nenet 10, 11, 13 e 38 të Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

Ndonëse shkaqet e mësipërme janë parashtruar nga pala kërkuuese në mënyrë evazive dhe jo mjaftësisht të argumentuar, Gjykata Kushtetuese, me qëllim që të arrijë në një përfundim të bazuar për shkeljen ose jo të të drejtave themelore të njeriut në një proces gjyqësor, me nismën e vet ka bërë një sërë verifikimesh.

Është e vërtetë se gjykimi në shkallë të parë është drejtuar nga një trup gjykues i përbërë prej një gjyqtari e dy ndihmësgjyqtarëve. Por, kjo përbërje e trupit gjykues, ka qenë në pajtim me ligjin e kohës në fuqi. Nga materialet e dosjes rezulton se shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 28.1.1995 dhe pas nëntë seancave gjyqësore, vendimi i gjykatës është shpallur më 21.6.1995. Hetimi i mirëfillt gjyqësor ka përfunduar në seancën e nëntë, më 06.05.1995. Në këtë seancë është vendosur pezullimi i çështjes për të bërë ekzaminimin psikiatrik të të pandehurve. Në seancën e fundit, me datë 21.6.1995 janë

lexuar aktekspertizat e bëra më datë 23.5.1995 dhe pasi janë dëgjuar kërkimet e fundit të palëve, po atë ditë është shpallur vendimi i gjykatës.

Në këto kushte del se gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar hetimin gjyqësor gjatë kohës që Ligji nr.7921, datë 19.4.1995 ende nuk kishte hyrë në fuqi. Ky ligj, sipas të Fletores Zyrtare ka hyrë në fuqi më 15.6.1995. Pas kësaj date gjykata nuk ka bërë asnjë hetim të mëtejshëm. Do të ishte absurde që ajo gjykatë të niste nga e para shqyrtimin gjyqësor, vetëm pse nuk është dhënë vendimi përfundimtar deri në atë kohë.

Përsa i përket ndihmësgjyqtarëve që përbënin trupin gjykues, Gjykata Kushtetuese ka bërë një sërë verifikimesh, duke kërkuar të dhëna nga Ministria e Drejtësisë, Arkivi i Shtetit, Zyra e Arkivit të Presidencës, e Këshillit të Ministrave si dhe ka marrë sqarime nga ish-gjyqtari ushtarak që ka kryesuar trupin gjykues. Të dhënat kanë qenë jo të plota për atë periudhë, madje edhe kontradiktore. Nësa Ministria e Drejtësisë ka paraqitur një listë të ndihmësgjyqtarëve ushtarakë të rrethit të Durrësit, ku nuk figuron emri i dy ndihmësgjyqtarëve në fjalë, organet e tjera nuk kanë dokumenta për atë periudhë kohe. Nga ana tjetër, gjyqtari ushtarak Petrit Çeno në shpjegimet e tij, ndër të tjera, deklaroi se në kohën kur e ka gjykuar edhe këtë çështje, efektivisht ka patur vetëm tre ndihmësgjyqtarë, ndër të cilët dy janë ata që kanë formuar së bashku me të trupin gjykues.

Gjykata çmon se nuk ka prova të plota e të pakontestueshme për të arritur në përfundimin se dy ndihmësgjyqtarët nuk kanë qenë të caktuar më parë ose të miratuar më pas nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pretendimi se Gjykata e Kasacionit e ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e prokurorit pa u njoftuar i gjykuari, duke iu mohuar kështu e drejta e mbrojtjes, është e pabazuar. Nga shkresa e përpiluar me datë 7.11.1995 rezulton se me këtë datë (në ora 12.20'), pra gjashtë ditë para datës së gjyqit, u është komunikuar të gjithë të gjykuarve, duke përfshirë edhe kërkuesin, ankimi i Prokurorit të Përgjithshëm drejtuar Gjykatës së Kasacionit. Në këtë shkresë janë pasqyruar firmat e të gjykuarve si marrës të kopjeve të ankimit, si dhe firmat e tre personave zyrtarë që kanë bërë komunikimin.

Përsa i përket parregullsive dhe mangësive në hetimin paraprak dhe në gjykim, pretendimet e kërkuesit nuk mund të merren parasysh nga Gjykata Kushtetuese, pasi ato nuk përbëjnë shkelje të tilla të ligjit që çenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Nuk është në kompetencën e kësaj Gjykate të bëjë vlerësime për nivelin e hetimit paraprak dhe atij gjyqësor apo të bëjë çmimin e provave të marra në këto faza.

Në këto rrethana kërkesa për shpalljen antikushtetues të vendimit të gjykatës ushtarake të rrethit Durrës dhe të vendimit të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 9, 25 e 6 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.